

INFORMOHUNI NË SIGURI TË PLOTË

Ju mund të kërkonti të flisni privatisht me punonjësin social të qendrës e cila ju ka pritur. Nëse nuk keni mundësi të flisni me një punonjës social, ju mund të telefononi për të kuptuar se si mund të vendoseni në një vend të sigurt dhe të përfitoni të drejtat tuaja.

Para se të telefononi

- Sigurohuni të jeni në një vend të sigurt dhe të keni kohën e mjaftueshme për të folur,
- Verifikoni telefonin tuaj që ai të jetë i karikuar,
- Mendoni më parë pyetjet që doni të bëni : cilat janë problemet që ju detyrojnë të qëndroni në këtë marrëdhënie të dhunshme ?

Gjatë telefonatës suaj

- Nëse keni nevojë kërkonti një përkthyes,
- Bëni të gjitha pyetjet e nevojshme,
- Kërkonti një adresë afër vendit ku jetoni ku keni mundësinë të takoni një punonjës i cili mund t'ju ndihmojë.

Biseda juaj do të jetë konfidenciale

NE RAST RREZIKU :

Policia : 17

PËR TË FOLUR MBI :

DHUNËN NDAJ GRAVE : 39 19

AGRESIONIN SEKSUAL : 0 800 05 95 95 [Collectif féministe contre le viol]

MARTESËN ME FORCË : 01 30 31 05 05 [Voix de femmes]

PRERJEN DHE DËMTIMIN E ORGANIT GJENITAL TEK FEMRAT : 39 19 PËR TË

RRITURIT, 119 PËR TË MITURIT [Allo enfance en danger]

SHFRYTËZIMIN, PROSTITUCIONIN ME FORCË : 0825 009 907 [Association ALC]

JU NUK JENI VETËM PËRBALLË DHUNËS



www.france-terre-asile.org/projet-swim



Partenaires européens



Italy
Associazione
Croce Rossa
Italiana



Great Britain
British Red Cross



France
France terre d'asile



Italy
Fondazione ISMU



Romania
Asociația
Alternative Sociale



Sweden
Svenska
Roda Korset



Cette brochure est financée par le Programme de l'Union européenne pour l'égalité des droits et la citoyenneté (2014-2020). Le contenu de ce rapport ne représente que le point de vue de l'auteur et constitue sa seule responsabilité. La Commission européenne n'assume aucune responsabilité quant à l'utilisation qui peut être faite des informations qu'elle contient.



Ce projet est financé par le Programme de l'Union Européenne pour les droits, l'égalité et la citoyenneté (2014 – 2020)



A NDIHENI NË SIGURI ?

- ❖ A keni frikë nga një pjesëtar i familjes suaj ?
- ❖ A është i dhunshëm ndonjë i afërmi juaj ndaj jush?
- ❖ A ndiheni e kërcënuar, e ofenduar apo e poshtëruar nga një i afërm i juaj ?
- ❖ A keni frikë, ndiheni e përndjekur, a ju kërcënon dikush për t'ju bërë keq apo për t'ju kontrolluar?
- ❖ A ka njeri që ju prek në trup, edhe pse ju nuk jeni dakort ?
- ❖ A ndiheni e detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale me partnerin tuaj apo me ndonjë person tjetër ?
- ❖ A ka ndonjë njeri që ju kërcënon se do i bëjë keq fëmijëve tuaj apo do ti rrëmbejë ato ?
- ❖ A ndiheni e detyruar ti kërkoni leje dikujt për të shpenzuar paratë tuaja, për të dalë nga shtëpia, për të folur me njeri në telefon, për të takuar miqtë apo familjen tuaj ?
- ❖ A i ka prishur dikush gjërat tuaja për t'ju frikësuar apo për t'ju kontrolluar ?
- ❖ A ju ka fshehur dikush pashaportën tuaj apo dokumenta të tjera të rëndësishme ?
- ❖ A keni qenë viktimë shantazhi ?
- ❖ A ka ndonjë njeri që ju detyron të martoheni pa dëshirën tuaj?
- ❖ A ka ndonjë njeri i cili cënon integritetin tuaj fizik ?

Nëse ndonjëra nga këto përgjigje është pozitive, ju jeni ndoshta viktimë e një situatë dhune dhe kontrolli ndaj jush.

NUK ËSHTË PËR FAJIN TUAJ

Secili nga ne mund të jetë viktimë e dhunës, pavarësisht nga mosha e tij, nga etnia, nga nënshtetësia, nga feja, nga orientimi i tij seksual, nga niveli i tij i jetesës apo nga vendi ku jeton.

Ju nuk jeni aspak përgjegjëse për atë që ju ndodh, nuk është për fajin tuaj.

Dhuna dhe poshtërimet nuk duhen të pranohen kurrë.

Ju keni të drejtë të ndihmoheni dhe të mbroheni nga drejtësia, në të gjitha shtetet europiane.

Ju nuk jeni vetëm, punonjësit socialë dhe avokatët janë pranë jush për t'ju ndihmuar.

Nuk duhet të keni turp të flisni, sepse vetëm fjala juaj mund ti ndryshojë gjërat.

JU KENI TË DREJTA

- ❖ Ju mund të bëni kërkesën tuaj të azilit, veçmas asaj të paraqitur nga bashkëshorti juaj apo familja juaj, ju keni të drejtë të paraqiteni në një takim të veçantë në Ofra dhe ndaj jush të merret një vendim individual.
- ❖ Në lidhje me përçapjet tuaja juridike apo shëndetësore, ju mund të kërkoni të merreni në takim nga një grua dhe të ndihmoheni nga një përkthyes e cila është femër.
- ❖ Ju mund të kërkoni që takimet tuaja të bëhen në një vend të veçantë.
- ❖ Nëse jeni viktimë dhune apo përndjekje ju keni të drejtë të merrni këshilla juridike falas në lidhje me :
 - sigurinë tuaj,
 - mbajtjen e fëmijëve tuaj,
 - ndarjen e të ardhurave financiare të familjes,
 - procedurat e marrjes së lejes të qëndrimit, procedurën e divorcit.
- ❖ Ju keni të drejtë të kërkoni një strehim të veçantë.
- ❖ Ju keni të drejtë të merrni ndihmën mjekësore që ju nevojitet pas asaj që ju ka ndodhur.
- ❖ Ju keni të drejtë e një ndihme psikologjike për të kaluar këto eksperiencë të vështira.